



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenit 3 paragrafi 5 dhe 17 paragrafi 1.5 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Vendimit komunal nr.prot.01-400/03-0084071/22 për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2024-2025, Vendimit nr.74 të datës 11.01.2023 të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, miratoi këtë,

### **VENDIM**

#### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 20,640.00€ për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike - Kompania Rajonale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” Sh.a.

##### **Neni 2**

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria e subvencioneve, (*programi buxhetor 48005-Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik*), dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të Ndërmarrjes, me theks përmbushjen e obligimeve / borxhit ndaj Kreditorit - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë - KMDK Sh.a.

##### **Neni 3**

Shuma e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhirollogarinë bankare të KRM “Pastrimi”

##### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

##### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0008895/23  
Podujevë, datë, 31 janar 2023





Komisioni Komunal i Aksionarëve, në mbledhjen e dt 11.01.2023 pas dakordimit të përgjithshëm dhe duke u bazuar nga kometencat nga Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëri Tregtare dhe Ligji Nr. 03/L-087 për Nderrmarje Publike, me datë 11.01.2023, propozon dhe aprovon këtë :

### V E N D I M

I. Lejohet subvencionimi – pagesa e borxhit ndaj Kreditorit KMDK Sh.A, në vlerë prej 20% nga borxhi i përgjithshëm i KMDK-së.

II. Komunat dakordohen që subvencionimin ta bejne ne bazë të logaritjes së borxhit te pergjithsëm për vitin 2022, si në vijim:

- Komuna e Prishtinës – 56% apo në shumë prej 112,760.00 euro;
- Komuna e Fushë Kosovës – 12.45% apo në shumë prej 24,900.00 euro;
- Komuna e Podujevës – 10.32% apo në shumë prej 20,640.00 euro;
- Komuna e Lipjanit – 8.88% apo në shumë prej 17,760.00 euro;
- Komuna e Drenasit – 6.66 % apo në shumë prej 13,320.00 euro;
- Komuna e Obiliqit – 5.25% apo në shumë prej 10,500.00 euro.

II Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit të vendimit respektivisht nënshkrimit nga Aksionarët e Komunave të lartëcekura dhe i njejti do ti dergohet Kryesuesit të Komunës dhe Kryetarve të Komunave .

### A r s y e t i m

Komisioni Komunal i Aksionarëve duke shqyrtuar si kërkesë urgjente për subvencionim të borxhit ndaj KMDK-së në vlerë prej 20% si në pikën I të këtij vendimi, ka arritur dakordim të përgjithshëm se kjo vlerë e mjeteve ndikon në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në ndërmarrje. Prandaj është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**In dërgohet:**

- KRM "Pastrimi" Sh. A
- Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Kryetarëve të Komunave,
- Arkivës

**Lista e nënshkrimeve të aksionarëve të KRM "Pastrimi":**

1. Shegë Beqiri
2. Bekim Brestovci
3. Muhamet Selmani
4. Mimoza Abdullahu
5. Bahri Selimi
6. Ilir Hasani
7. Habib Mekolli
8. Lumnije Krapi
9. Ardit Cani
10. Fadil Sopa
11. Valon Pacolli
12. Abdurrahman Krasniqi
13. Fidan Ahmeti

*[Handwritten signatures of 13 shareholders on lined paper]*

